



Përditësim

Mirë se vini në informimin javor të Dhomave të Specializuara të Kosovës, ku synojmë t'u ofrojmë gazetarëve informacion të përditësuar mbi zhvillimet e fundit në Gjykatë dhe mundësinë për të bërë pyetje.

Në çështjen gjyqësore të Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit, këtë javë dha dëshmi dëshmitari i katërt i thirrur nga Mbrojtja e Thaçit. Xhejms Kovi (James Covey) ishte zëvendës i parë i Përfaqësuesit Special i Kombeve të Bashkuara në Kosovë gjatë periudhës që lidhet me Aktakuzën. Z. Kovi përfundoi dhënien e dëshmisë sot.

Në të njëjtën çështje gjyqësore, më 26 shtator, Trupi Gjykses miratoi një kërkesë të Mbrojtjes për t'u liruar nga detyrimet për nxjerrjen e informacionit në lidhje me disa redaktime të kufizuara që u bënë në tri dokumente. Këto redaktime u bënë nga subjekti që i dha dokumentet.

Sipas rregullës 107 të Rregullores së Procedurës dhe të Provave, në qoftë se Zyra e Prokurorit ka në ruajtje ose kontroll informacion që i është dhënë në mënyrë konfidenciale dhe vetëm për mbledhjen e provave të reja, një informacion i tillë dhe burimi përkatës mbrohen sipas Ligjit dhe nuk nxirret pa pëlqimin e dhënësit. Në këtë rast, Trupi Gjykses vë në dukje se pasi Prokuroria i përsëriti kërkesën dhënësit të dokumenteve, më 12 shtator 2025 dhënësi nuk pranoi që ato të nxirreshin plotësisht.

Përveç përditësimit të rregullt mbi statusin e çështjes gjyqësore, sot dëshirojmë të shfrytëzojmë rastin të vëmë në dukje një numër deklaratash të pasakta në media kohët e fundit në lidhje me proceset gjyqësore, dhe të sqarojmë disa aspekte.

Së pari, z. Thaçi dhe të bashkakuzuarit e tij në këtë çështje gjyqësore u arrestuan në bazë të aktakuzës së konfirmuar nga Gjykatësi i Procedurës Paraprake. Akuzat kundër tyre u ngritën në përputhje me Ligjin, përpara se ata të arrestoheshin.

Gjykatësi i Procedurës Paraprake konfirmoi aktakuzën pasi konstatoi se provat e paraqitura nga Prokuroria vërtetuan dyshimin e bazuar mirë se të akuzuarit kishin kryer krimet e luftës dhe krimet kundër njerëzimit të paraqitura në Aktakuzë.

Së dyti, arsyeja përse secili nga të katër të akuzuarit në këtë çështje gjyqësore po mbahet ende në paraburgim është se gjykatësit kanë vlerësuar se për secilin prej të akuzuarve ekziston rreziku që të pengojë ecurinë e procesit dhe të kryejë vepra penale të tjera, në veçanti kundër personave që kanë dhënë dëshmi ose që pritët të japin dëshmi para Dhomave të Specializuara.

Për secilin të akuzuar, gjykatësit vlerësojnë çdo dy muaj nëse paraburgimi është i përligjur dhe proporcional, duke zbatuar standardet e së drejtës ndërkombëtare dhe të të drejtave të njeriut.





Në rastin e z. Thaçi, një pjesë e arsyetimit në vendimet e fundit për paraburgimin ka të bëjë me tregues se z. Thaçi mund t'u ketë zbuluar informacion konfidencial lidhur me dëshmitarë të ardhshëm vizitorëve në objektin e paraburgimit dhe i udhëzoi ata të ushtronin ndikim të paligjshëm ndaj dëshmive të tyre.

Së fundi, sa i takon të drejtës për gjykim të drejtë, është me rëndësi të theksohet se gjykata ka mekanizma që garantojnë respektimin e të drejtave të të akuzuarve në të gjitha çështjet gjyqësore, përfshirë mundësinë që t'i paraqesin kërkesë referuese Dhomës së Specializuar të Gjykatës Kushtetuese dhe përmes procesit të rregullt të apelit, përmes të cilit vendimet e një paneli gjykatësish mund të kundërshtohen nga një panel i pavarur i përbërë nga gjykatës të tjerë.

Në vazhden e përditësimeve në lidhje me proceset, në çështjen gjyqësore të Hashim Thaçit, Bashkim Smakajt, Fadil Fazliut, Isni Kilajt dhe Hajredin Kuçit në lidhje me pretendime për ndikim të paligjshëm ndaj dëshmitarëve, më 29 shtator, Prokuroria njoftoi Gjykatësen e Procedurës Paraprake për faktet për të cilat janë pajtuar palët në këtë çështje. Për ta bërë procesin më të shpejtë, Rregullorja përcakton se gjykatësi evidenton çdo pikë faktike ose juridike për të cilën pajtohen Prokuroria dhe Mbrojtja para fillimit të gjykimit.

Kujtojmë se Gjykatësja e Procedurës Paraprake njoftoi se ajo synon t'ia kalojë çështjen trupit gjykues në gjysmën e parë të nëntorit 2025, në varësi të vendimeve mbi mocione paraprake që do të jepen nga Paneli i Gjykatës së Apelit.

